

# Refugee agencies help and advice



28/03/08

Albanian

## Përkrahja nga **Section 4\*** Kuponët Suplementarë

Disa persona që marrin përkrahje nga **Section 4** i **UKBA (Home Office)\*** tani mund të aplikojnë për kuponë suplementarë. Kjo fletëpalosje ju shpjegon se cilët mund të aplikojnë dhe për çfarë mund të aplikojnë.

### Gjithkush që merr përkrahje nga **Section 4\*** mund të aplikojë për kuponë suplementarë për:

#### 1. Udhëtim për distanca mbi 3 milje (4.8 km) – nëse ky udhëtim është:

- Për të marrë trajtim mjekësor (në aplikim përfshini prova të takimit me mjekun); ose
- Për të regjistruar një lindje.

#### 2. Certifikata lindje – Për të paguar koston e marrjes së një certifikate të plotë lindje.

#### 3. Telefonata dhe letra:

Për të paguar koston e telefonatave dhe tarifave postare / kancelarive të kryera ose dërguara për:

- doktorët / kujdesin shëndetësor
- një avokat të kualifikuar për dhënien e këshillave për emigracionin
- një gjykatë ose gjyq
- një shërbim **One Stop Service\***
- zyrën **Citizen's Advice Bureau\***
- një organ vendor
- një zyrtar të emigracionit; ose
- **Home Office (UKBA)\***

### Përkrahje suplementare për gratë shtatzëna dhe prindërit me fëmijë në ngarkim nën moshën 16 vjeç:

4. **Një kupon tek (£250) për çdo fëmijë të porsalindur** – Ju mund të aplikoni për këtë më pak se 8 javë përpara datës kur pritët lindja ose më pak se 6 javë pasi të ketë lindur fëmija.

#### 5. Kuponë suplementarë javorë për gratë shtatzëna dhe fëmijët nën tre vjeç:

- Kupon suplementar prej £3 në javë për kohëzgjatjen e shtatzënisë
- Kupon suplementar prej £5 në javë për çdo fëmijë të porsalindur deri në moshën një vjeçare

Registered charity numbers: Refugee Action: 283660 Migrant Helpline: 1088631  
Scottish Refugee Council: SCO08639 Refugee Council: 1014576 Welsh Refugee Council: 1044885

Fletëpalosje të tjera mund të gjenden në <http://languages.refugeecouncil.org.uk>

Document control: commissioning agency, review date



- Kupon suplementar prej £3 në javë për çdo fëmijë nga mosha një vjeç deri kur të arrijnë moshën 3 vjeç.

**6. Kuponë suplementarë për veshjet për fëmijët:**

- Kupon suplementar prej £5 në javë për çdo fëmijë deri kur mbush 16 vjeç.

**7. Nevoja të veçanta specifike:**

- Nëse ekziston një nevojë e veçantë për udhëtim, telefonatë, tarifë postare/kancelari ose nevojat bazë jetësore, që nuk është mbuluar më sipër, personat mund të aplikojnë dhe duhet të përfshijnë provat për këtë nevojë.

**Mënyra e aplikimit:**

Formulari i aplikimit gjendet në faqen e internetit të [UKBA\\*](#). Për të bërë aplikimin pranë [UKBA\\*](#) për kuponë suplementarë mund t'ju ndihmojë kushdo duke përfshirë edhe siguruesin e strehimit. Nëse ju refuzohet aplikimi, ju nuk do të jeni në gjendje të apeloni.

**1. Për rastet e zgjidhjeve të çështjeve (aplikim për azil përpara muajit Prill 2007):**

Dërgoni me faks formularin e aplikimit te ekipi i [Croydon Section 4\\*](#) – formulari i aplikimit gjendet në faqen e internetit:

<http://www.bia.homeoffice.gov.uk/sitecontent/applicationforms/asylum/casesresolutionsection4provision>

**2. Nëse keni një përgjegjës të çështjes sipas [NAM](#) (aplikim për azil pas muajit Prill 2007):**

Dërgoni me faks formularin e aplikimit te përgjegjësi për rastin pranë ekipit rajonal për azilin

<http://www.bia.homeoffice.gov.uk/sitecontent/applicationforms/asylum/section4provision>

Gjithmonë duhet të përfshini provat, për shembull:

- Prova të nevojave shëndetësore
- Një [MATB1\\*](#), ose një certifikatë lindje (kur fëmija nuk është i regjistruar pranë [UKBA\\*](#))

Nëse keni pyetje ose hasni vështirësi me aplikimin, ju lutemi flisni me siguruesin e strehimit ose kontaktoni agjencinë vendore të informacionit në:

\*Këto fjalë janë emrat në anglisht të organizatave ose fjalë të tjera që nuk mund të përkthehen. Ju lutemi kërkojini një punonjësi të informacionit që t'ju shpjegojë kuptimin e tyre.